



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201802001/17

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda :** *Rekomandohet kryerja e veprimeve për përmbushjen e detyrimit sikurse parashikuar në nenin 196 të Kodit Civil, si dhe nenin 38/3 të ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.*

**Drejtuar :** Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës  
Pranë : Këshillit të Qarkut

**FIER**

I nderuar zotëri!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetases L.M., në të cilën është prezantuar shqetësimi i mosregjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme i titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë, nr.829, datë 11.06.2004, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, dhe lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Vlorë me Vendimin nr. 245, datë 27.05.2005, me objekt ; "Pjestim pasurie". Objekt pjestimi sipas vendimit gjyqësor të lartpërmendur ka qenë pasuria e përfituar në pronësi sipas ligjit 7501/1991 "Për tokën", i ndryshuar, nga ana e Familjes së M.N., dhe pasqyruar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr.11678, datë s'ka, nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec.

Sipas AMTP-së nr.11678, datë s'ka, nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec, rezulton se, Familja N. ka përfituar në pronësi 5 ngastra tokë bujqëse me sipërfaqe të përgjithshme prej 10202m<sup>2</sup>, dhe ekstremitete sikurse përcaktuar në këtë Akt.

Me rastin e pjestimit të pasurisë së Familjes N, është kërkuar prej ankuses pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, (ZVRPP) Fier, mundësimi i regjistrimit të vendimit gjyqësor të lartpërmendur dhe me këtë rast lëshimi i dokumenteve të pronësisë ankuses për pjesën takuese. Në përgjigje të kërkesës (aplikimit) së kryer prej ankuses L.M., ZVRPP, Fier, në shkresën nr. 8348/1 prot, datë 21.11.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet midis të tjerave se :

*“Nga verifikimi i sistemit dixhital të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në ZVRPP, Fier, nuk rezulton që Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (autori - AMTP nr.11678, datë s’ka, nxjerr prej ish-Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec) i cili është dhe titulli i pronësisë të jetë sjell për regjistrim nga ndonjë institucion sipas përcaktimeve ligjore në fuqi”.*

Referuar situatës së prezantuar prej ZVRPP, Fier, është kërkuar Bashkisë, Roskovec, informacion nëse prej ish-Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, apo vet Ajo, kanë mundësuar dërgimin për regjistrim pranë ZVRPP Fier, të AMTP-së nr.11678, datë s’ka, nxjerr prej ish-Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec, në favor të Familjes N.

Në përgjigje të informacionit të kërkuar, Bashkia, Roskovec, me shkresat nr.4333/1 Prot, datë 02.11.2018 dhe nr. 4333/3 Prot, datë 21.11.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, konfirmon midis të tjerave se :

*“Pas kërkimit nga Drejtoria e Arkivit të Dokumentacionit, Kulturës, Arsimit dhe Shëndetësisë, Sektori i Protokollit dhe Arkivave, nuk rezulton dokumentacion në emër të zotit M.N. i nisur në ZVRPP, Fier”.*

Ndodhur në kushtet e lartpërmendura të çështjes, Institucioni i Avokatit të Popullit, gjykon se, nuk është respektuar dhe nuk respektohet detyrimi ligjore për dërgimin për regjistrim të titullit të pronësisë (AMTP-së nr. 11678, datë s’ka, dhënë Familjes N.) pranë ZVRPP, Fier, sikurse parashikuar në nenin 193/h dhe 196 të Kodit Civil, në të cilët respektivisht parashikohet se ;

*Neni 193/h*

*“Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:*

*h) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjestimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankand të tyre. ...”;*

*Neni 196*

*“Gjykatat, noterët, përmbaruesit gjyqësor dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t’i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë”;*

apo nenin 38/3 të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar, se

*Neni 38*

*“Regjistrimi i detyruar*

*“... 3. Gjykatat, noterët, përmbaruesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore i dërgojnë zyrës, që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme ose të një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të tyre....”;*

Detryrimi i parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituar, referuar përgjigjes së dhënë prej Bashkisë, Roskovec, me shkresat nr.4333/1 Prot, datë 02.11.2018 dhe nr. 4333/3 Prot, datë 21.11.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, kuptohet se nuk është përmbushur. Ky qëndrim i mbajtur prej organeve shtetërore që kanë pasur dhe kanë detyrimin e respektimit të parashikimit të kryer në dispozitat ligjore të lartpërmendura, është tregues i shkeljes të së drejtës të pronësisë për subjektet përfitues, si dhe cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të mbrojtura dhe garantuara sikurse sanksionuar në nenin 41, 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nenin 1 të Protokollit nr.1, nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, mospërmbushja e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 193/h, 196 të Kodit Civil, nenin 38 të ligjit nr.33/2012, nga ana e organeve shtetërore është tregues i mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë sikurse parashikuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, i detyrueshëm për respektim në kuptim dhe zbatim të parashikimit të nenit 1 të Ligjit nr.44/2015 (Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë).

Situata në të cilën ndodhet respektimi i detyrimit ligjor për dërgimin nga ana e DAMT-së, pranë Këshillit të Qarkut, Fier, të kopjes së Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr.11678, datë s'ka, nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec, në Favor të Familjes N., është krejt e pajustificueshme, e për rrjedhojë kërkon ndërhyrje emergjente për mundësimin e ndërprerjes së cënimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individit.

Për arsyet si më sipër bërë të ditur, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në parashikimin e kryer në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin thuhet, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenit 21/b, të Ligjit nr.8454, date 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*.

## **REKOMANDOJMË**

*Kryerjen e veprimeve për përmbushjen e detyrimit të dërgimit pranë ZVRPP, Fier, të kopjes së Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) nr.11678, datë s'ka, nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Kuman, Roskovec, sikurse parashikuar në nenin*

*196 të Kodit Civil, si dhe nenin 38/3 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kërkojmë mundësimin e kthimit të përgjigjes brenda afatit ligjor prej 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Me besim në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**

**Konceptoi dhe Daktilografoi: A.Gjoleka**